

Në bazë të nenit 158-s pika 1) dhe në lidhje me nenin 163 paragrafi (5) dhe neni 18 paragrafi (7) të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve -teksti i konsoliduar ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 30/2012, Këshilli i Eekspertëve të Agjencisë të Mbikqyrjes të Sigurimeve miratoi

RREGULLORE

për përmbajtjen e njoftimeve të rregullta të cilat shoqëritë e sigurimeve/ose risigurimeve dhe subjekte të tjerë i dorëzojnë në Agjencinë e Mbikqyrjes të Sigurimeve në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrje të Sigurimeve

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore parashkruhet përmbajtja e njoftimeve të cilat shoqëritë e sigurimeve /ose risigurimeve (në tekstin si më poshtë: shoqëritë e sigurimeve) dhe subjekte të tjerë i dorëzojnë në Agjencinë për Mbikëqyrje të Sigurimeve (në tekstin si më poshtë: Agjencia), në baza të rregullta ose me kërkesë të Agjencisë dhe afatet për dorëzimin e tyre në Agjenci, në përputhje me Ligjin për Mbikqyrje të Sigurimeve (në tekstin si më poshtë: Ligji).

Raportim nga ana e shoqërive të sigurimeve

Neni 2

Shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara të njoftojnë Agjencinë për:

1. ndryshimin e të dhënave të regjistruara në regjistrin tregtar;
2. konvokimin e Asamblesë të aksionarëve, si dhe të gjitha konkluzionet e miratuara;
3. planin për hapjen, transferimin, mbylljen ose ndarjen e përkohshme të një filiali apo zyre përfaqësimi në vend ose në një shtet anëtar ose ndryshimin e llojit të aktiviteteve të kryera nga filiali;
4. investimet kapitale të shoqërive të sigurimeve në një person tjetër juridik që janë më pak se 10% e kapitalit të shoqërisë së sigurimeve, si dhe çdo investim tjetër në atë person juridik;
5. ndërprerjen e kryerjes së veprimtarive të sigurimit për klasa të caktuara;
6. ndryshimi në strukturën e pronësisë së aksioneve me të drejtë menaxhimi, përveç në rastet e nenit 18 paragrafi (1) të ligjit;
7. ka bazë për ndërprerjen e shoqërisë së sigurimit ose për revokimin e licencës për kryerjen e veprimtarive të sigurimit;
8. ndryshime në aktet e politikës afariste lidhur me klasat e sigurimeve të përmendura në nenin 5 pika 2 dhe 10 të këtij ligji;
9. shkarkimin dhe emërimin e anëtarëve të organeve menaxhuese;
10. shkarkimi i aktuarit të autorizuar;
11. ndryshimi i auditorit të brendshëm;

12. Futja e produkteve të reja dhe ndryshimi i Tarifave të primeve dhe Kushteve për sigurim, si dhe bazën teknike të përdorur për përcaktimin e tyre dhe

15) subjektet që kryejnë veprimtaritë e referuara në nenet 133 paragrafi (2) dhe 135 paragrafi (2) të Ligjit për Mbikqyrje të Sigurimeve.

Raportim nga ana e shoqërive të sigurimeve

Neni 3

(1) Në lidhje me nenin 2, pika 1 e kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë njoftimin ose kërkesën bashkë me të gjitha materialet shtesë bashkangjitur njoftimit/kërkesës të cilat dorëzohen në Rregjistrin Qendror, në të njëjtën kohë me dorëzimin e tyre në Rregjistrin Qendror, ndërsa Vendimin për regjistrimin e ndryshimeve në Regjistrin Qendror në afatin 5 ditë pune nga dita e pranimi të vendimit.

(2) Në lidhje me nenin 2 pika 2 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë Vendimin për konvokimin e Asamblesë të aksionerëve bashkë me ftesën apo thirrjen publike për mbajtjen e Asamblesë të aksionerëve, rendin e ditës dhe të gjitha Propozim vendimet të cilat do të shqyrtohen në Asamble, në afatin 5 ditë nga dita e marrjes të Vendimit për konvokimin e Asamblesë të aksionerëve. Shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë Procesverbalin e Kuvendit të aksionerëve, ndërsa në rastet e parashikuara me Ligjin për shoqëritë tregëtare, të vërtetuar nga person i autorizuar-noter, bashkë me të gjitha Vendimet të cilat janë marrë në kuvendin e aksionerëve, në afatin 5 ditë nga dita e mbajtjes të kuvendit të aksionerëve.

(3) Në lidhje me nenin 2 pika 3 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë vendimet e marra për hapjen e planifikuar, transferimin, mbylljen ose ndarjen e përkohshme të një filiali apo zyre përfaqësimi në vend ose në një shtet anëtar ose ndryshimin e llojit të aktiviteteve të kryera nga filiali, në afatin 5 ditë nga dita e marrjes të vendimit.

(4) Në lidhje me nenin 2 pika 4 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë kontratën ose dokument tjetër të përshtatshëm për arritjen e interesit pjesëmarës ose investim në afatin 5 ditë nga dita e arritjes të interesit pjesëmarrjes apo investimit.

(5) Në lidhje me nenin 2 pika 5 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë vendimet e marra për ndërprerjen e kryerjes së veprimtarive të sigurimit për klasa të caktuara në afatin 5 ditë nga dita e marrjes të vendimit.

(6) Në lidhje me nenin 2 pika 6 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë Raportin e Aksionerëve të cilët kanë arritur interes pjesëmarës më pak se 10% të aksioneve me të drejtë vote në shoqëritë e sigurimeve me dorëzimin e të dhënave personale të aksionerit, emërtimin dhe selinë, vlerën nominale të aksioneve që i posedon dhe përqindjen e interesit pjesëmarës me të drejtë vote në shoqëri, në afatin 5 ditë nga dita e arritjes të interesit pjesëmarrës.

(7) Në lidhje me nenin 2 pika 7 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara që në Agjenci të dorëzojnë raport bashkë me materialet e nevojshme, menjëherë pa vonesë.

(8) Në lidhje me nenin 2 pika 8 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë Vendim për miratimin e akteve të reja ose ndryshimin/plotësimin e akteve ekzistuese të politikave afariste lidhur me klasat e sigurimeve të përmendura në nenin 5 pika 2 dhe 10 të këtij ligji;

(9) Në lidhje me nenin 2 pika 9 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë Vendim për shkarkimin ose emërimin e anëtarit ose anëtarëve të organeve menaxhuese

menjëherë pa vonesë. Anëtarët e organit menaxhues janë të obliguar për çdo emërim apo ndërprerje të ushtrimit të funksionit në organin menaxhues në shoqëri të njoftojnë me shkrim Agjencinë duke dorëzuar Vendimin në bazë të të cilit ka ndryshuar statusi i tyre, menjëherë pa vonesë.

(10) Në lidhje me nenin 2 pika 10 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjension të dorëzojnë Vendim për emërimin ose shkarkimin e aktuarit të autorizuar në afatin 5 ditë nga dita e marrjes të vendimit.

(11) Në lidhje me nenin 2 pika 11 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjension të dorëzojnë Vendim për emërimin ose shkarkimin e auditorit të brendshëm në afatin 5 ditë nga dita e marrjes të vendimit.

(12) Në lidhje me nenin 2 pika 12 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë Vendim për futjen e produkteve të reja të sigurimeve ose ndryshimin/plotësimin e produkteve ekzistuese të sigurimeve (Tarifa dhe Kushte për sigurime). Me qëllim kontrollin e Tarifave dhe Kushteve dhe a janë këto në përputhje me parimet aktuariale dhe rregullat e kësaj fushe, shoqëria e sigurimeve është e obliguar bashkë me Vendimin, në Agjenci të dorëzojë tekstin e konsoliduar të Tarifave dhe Kushtev të reja ose të ndryshuara për sigurime, si dhe bazën teknike që janë përdorur për përcaktimin e tyre të mbështetura këto me mendimin e aktuarit të autorizuar.

(13) Në lidhje me nenin 2 pika 13 të kësaj rregulloreje, shoqëritë e sigurimeve janë të obliguara në Agjenci të dorëzojnë Vendim për lidhjen e kontratës për bashkëpunim afarist me subjektin juridik që do të kryejë veprimtari për përgatitjen dhe lidhjen e kontratave për sigurime në bazë të përjashtimeve të përcaktuara në nenet 133 paragrafi (2) dhe 135 paragrafi (2) të ligjit bashkë me Kontratën për bashkëpunim afarist, në afatin 5 ditë nga dita e marrjes të Vendimit, ose 5 ditë nga dita e lidhjes të kontratës.

Raportime nga ana e anëtarëve të organit menaxhues

Neni 4

Organi menaxhues në shoqëritë e sigurimeve është i obliguar menjëherë, pa vonesë, me shkrim të njoftojë Agjencinë e Mbikëqyrjes të Sigurimeve, nëse:

1. është rrezikuar likuiditeti ose aftësia paguese e shoqërisë;
2. egzistojnë arsye për revokimin e licencës për kryerjen e veprimtarive të sigurimit ose për revokimin e licencës për kryerjen e veprimtarive të sigurimit për një klase të veçantë sigurimi dhe
3. gjendja financiare e shoqërisë të sigurimeve ka ndryshuar dhe sipas kësaj shoqëria e sigurimeve nuk e siguron më nivelin e domosdoshëm të aftësisë paguese në përputhje me nenet 75 ose 76 të Ligjit.

Raportime nga ana e subjekteve të tjera

Neni 5

Subjekti fizik ose juridik i cili nga Agjencia ka marrë miratimin për arritjen e interesit pjesëmarrës të kualifikuar në shoqërinë e sigurimeve, është i obliguar të njoftojë Agjencinë për qëllimin e tij të shesë ose në mënyrë tjetër të tjetërsojë aksionet e fituara në shoqërinë e sigurimeve, me këtë do të zvogëlohet pjesëmarrja e tij nën limitin për të cilin ka marrë miratim dhe për këtë në Agjension të dorëzojë njoftim për mënyrën e tjetërsimit dhe eventualisht personi i cili do të zotërojë këto aksione, menjëherë pa vonesë.

Saktësimi i formës të dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm për zbatimin e rregullores

Neni 6

Shoqëritë e sigurimeve , anëtarët e organit menaxhues dhe subjektet në bazë të nenit 5 të kësaj Rregulloreje janë të obliguar dokumentacionin të cilin e dorëzojnë bashkangjitur njoftimit dhe që është përcaktuar në këtë rregullore, ta dorëzojnë në original ose kopje të noterizuar tek personi i autorizuar (noter) firmosur nga personi i autorizuar ose nga organi përgjegjës. Nëse dokumenti i cili duhet dorëzuar është në gjuhë tjetër, bashkë me origjinalin dorëzohet dhe përkthimi në gjuhën maqedonase, përkthyer nga përkthyes i autorizuar gjyqësor dhe noterizuar nga personi i autorizuar (noter)

Dorëzimi i dokumentacionit tjetër me kërkesë të agjencisë

Neni 7

Shoqëritë e Sigurimeve janë të obliguara me kërkesë të Agjencisë të dorëzojnë edhe informacione të tjera të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes në veprimtarinë e shoqërisë, ose kryerjen e kompetencave të tjera nga ana e Agjencisë

Dispozita përfundimtare

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës të Maqedonisë”.

Nr.0201-899/3

29.03.2012

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë

d.r Klime Popovski